



Pranuar / Dorezuar Primijsen / Predato Received / Delivered	30.03	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Br Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SPDMBHC	1730	2022	111	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 32/2022
Datë: 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Jeton KOCA

Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Arkivit të Këshillit.



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punë/Produkt Received/Delivered	30.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM8HCK	1730/2022		1120



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT
PËR VITIN 2020

në

MINISTRINË E INDUSTRIËSË NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJE	2
HYRJE.....	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT.....	4
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	5
FUSHA E MONITORIMIT.....	6
RAPORTI I MONITORIMIT NËMINISTRINË E INDUSTRIISË NDERMARRËSISË DHE TREGTISË.....	7-20

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tutje referuar si Këshilli*) është institucion i themeluar me Kushtetutë, me mandat specifik për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Këshilli, mandatin e tij kushtetues, *sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil* e realizon përmes funksioneve themelore të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si:

- *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil;*
- *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- *Kushtetutën e Republikës së Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë;*
- *Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;*
- *Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
- *Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;*
- *Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

FUNKSIONI I MONITORIMIT

Krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes se ankesave të nëpunësve civil dhe kandidateve për praninë në shërbimin civil, Këshilli ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Ketë funksion e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil me qëllim të krijimit të një administratë publike, profesionale dhe efikase, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksioni i monitorimit ushtrohet përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Përmes ushtrimit të funksionit të monitorimi të institucioneve të administratës publike Këshilli siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qëllim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Rastet e paraqitura lidhur me ngacmimet seksuale në institucionet e administratës publike;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT I MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVILË NË MINISTRINË E INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË PËR VITIN 2020

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për të vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të paanshme ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra nga zyrtaret përgjegjës të institucionit përkatës, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës monitoruese me datë 11.02.2022, në prezencë të Udhëheqësit të Njësisë për Burime Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të dokumenteve relevante (kopje), si në vijim:

Rregulloren Nr.29/201 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; Vendimet e ushtruesve të detyrës dhe zëvendësuesve; Dosjen për nëpunësit civil Zyrtar i Lartë për Promovimin e Investimeve; Dosjen e nëpunësit civil Zyrtar i Latë për Mallra Bujqësore dhe Industriale; Dosjen e nëpunësit civil Zyrtar Zotues; Dosjen e nëpunësit civil Zyrtar për Standardizim; Planin e Personelit; Marrëveshjet për shërbime të Veçanta; Vendimin e datës 06.05.2021 për formim të Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 22.12.2020 për formimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 02.07.2020 për formimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 20.07.2020 dhe 25.11.2020 për shqiptimin e masës disiplinore largim nga shërbimit civil; Vendimin e datës 11.09.2020 për shqiptimin e masës disiplinore ndalim i pagës 20% për 2 muaj; Vendimin e datës 11.12.2020 për refuzimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore; E-mailin nga Komisioni Disiplinor i datës 24.08.2020 për përfudnimin e një rasti pranë këtij komisioni; E-mailin e datës 03.03.2021 për Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë për deklarim të statusit të zyrtarëve publikë; E-mailin e datës 04.12.2020 të Burimeve Njerëzore lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020; Dosjen e vlerësimit të përiudhës proveuses për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor, Zyrtar i Lashtë për Cilësin e Naaftës dhe Produkteteve të Naftës, Zyrtar për të Hyra Financiare dhe Zyrtar për Marka Tregtare; Vendimin e datës 01.10.2020 për pushim pa pagesë për zyrtaren e Arkivit; Vendimin e datës 24.12.2019 për pushim pa pagesë për Zyrtaren e Lartë Juridike dhe Administrative; Vendimin e datës 28.09.2020 për Zyrtar e Lartë për Infrastruktura të Cilësisë së Notifikimeve; Vendimin e datës 04.03.2020 për Zyrtaren e Lartë Ekzekutive; Vendimin e datës 19.02.2019 për aprovues të lëndëve; Vendimin e datës 25.09.2019 për Zyrtar për Procedimin e lëndëve; Vendimin e datës 20.07.2020 për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil; Marrëveshjen e datës 15.07.2020 për transferim të përhershëm të nëpunësit civil; Vendimin e datës 26.12.2019 për pensionim të nëpunësit Inspektor i Lartë i Mbikëqyrjes së Tregut; Vendimin e datës 03.11.2020 për pensionimin e Inspektorit të Mbikëqyrjes së tregut të Naftës dhe Derivateve të Naftës; Vendimin e datës 19.06.2020 për pensionimin e Arkivistit; Vendimin e datës 05.02.2020 për

pensionimin e Udhëheqësit të Laboratorit; Vendimin e datës 14.02.2020 për pensionimin e Zyrtarit në Laboratorin e Naftës, Rrjedhës dhe Vëllimit; Vendimin e datës 27.07.2020 për pensionimin e Zyrtarit për Politika Turistike; Vendimin e datës 03.07.2020 për pensionimin e Arkëtarit; Vendimin e datës 11.12.2020 për pensionim të parakohshëm të Udhëheqësit të Diviziinit për Rregullim dhe Vëzhgim të Tregut të Naftës; Kërkesën për pension të parakohshëm te datës 01.12.2020; Vendimin e datës 30.04.2015 për pezullim parandalues me 50% të pagës për Zyrtaren e Metrologjisë për Madhësi Elektrike; Vendimin e datës 08.07.2020 për kthim në vendin e punës Zyrtare për Metrologji për Madhësi Elektrike; Vendimin e datës 25.11.2020 për pezullim nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin e datës 20.01.2021 të Këshilit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë për pezullim të Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin e datës 04.11.2015 për pezullim me 50% të pagës për Zyrtar i Materialit të Ndërtimit dhe Shfrytëzimit të Resurseve; Vendimin e datës 21.12.2015 për pezullim me 50% të pagës për Udhëheqësin e Sektorit për Projekte në Fushën e NVM-së; Vendimin e datës 13.01.2020 për pezullim me 50% të pagës për Zyrtar i Lartë për Standarde dhe Cilësi të Turizmit; Vendimin e datës 24.08.2018 për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës për Zyrtaren për Mbrojtjen e Konsumatorit; Vendimin e datës 13.02.2020 për pezullimin e dakorduar të marrëdhënies së punës për Zyrtaren Ligjore; Vendimin e datës 02.07.2020 për pezullimin e dakorduar të marrëdhënies së punës për Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave; Vendimin e datës 08.02.2021 për kthim në vendin e punës për Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave; Vendimin e datës 24.02.2021 për kthim në vendin e punës për Zyrtaren Ligjore; Vendimin e datës 01.20.2020 për dorëheqjen e nëpuësnit civil Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative; Vendimin e datës 31.08.2020 për dorëheqjen e nëpuësnit Zyrtar i Lartë për Koordinim të Politikave; Vendimin e datës 14.02.2020 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje për nëpuësin Udhëheqës të Diviziinit për Koordinim të Politikave; Planin Vjetor të trajnimit për vitin 2020; Akt Emërimet e 25 nëpuësve civil të komunitetit serb të punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kërkesën e datës 28.10.2020 në lidhje me çështjen e zyrtarëve të MCP-së; Informatën lidhur me çështjen e zyrtarëve të MCP-së në komunat veriore e datës 25.01.202; Kërkesën për MPB për stafin nga mbrojtja civile e datës 16.03.2021; Kërkesë e datës 23.10.2020; Provesverbalet e datës 31.01.2019, 25.01.2019 dhe 24.01.2019.

Kolegji i Këshilli, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e monitorimit të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Këshilli, gjatë vizitës që ka bërë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 11.02.2022, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren Nr.29/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, mirëpo për shkak të bashkimit të kësaj ministrie me Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është përgatit draft rregullorja e re dhe e njëjta është proceduar për shqyrtim në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në vitin 2020 në këtë institucion kanë qenë 253 të punësuar.

- Këshilli gjatë vizitës monitoruese ka shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil dhe rrjedhimisht është konstatuar se dosjet e personelit janë të kompletuara, përveç disa rasteve ku nuk janë përfshirë në dosje kërkesat e pushimeve, formularët e velrësimit të rezultateve në punë dhe formualrërt e përmbajtjejs së dosjeve personale të nëpunësit civil, respektivisht fleta prezantuese.
- Këshilli duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2020 ka pasur 25 pozita me ushtrues detyre apo zëvendësues të cilat vazhdojnë tutje.
- Sipas deklaramit të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është përgatitur lista e deklaramit të statusit të zyrtarëve publikë dhe e njëjta është përcjell në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Rrjedhimisht procesi i deklaramit të statusit të zyrtarëve publikë nuk ka qenë i përfunduar.

Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve të personelit, gjegjësisht mostrave të marra ka gjetur se dosjet e personelit nuk e përmbajnë formularin e përmbajtjes së dosjeve personale të nëpunësit civil, respektivisht fletën prezantuese, siç parashihet me dispozitat e nenit 4 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, përkatësisht nenin 4 paragrafi 3 dhe 4 përcaktohet se: *3. Dosja personale e zyrtarit publikë duhet të shoqërohet*

nga fleta prezantuese e krijuar nga zyrtari përgjegjës i Njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore e cila ka formën dhe përmbajtjen sipas shtojcës nr. 1.2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje; 4. Fleta prezantuese sipas paragrafit 3 të këtij neni nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar i njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës dhe nga vetë zyrtari publik, për të cilin është krijuar dosja personale.

Të gjitha institucionet që punësojnë zyrtarë publikë, janë të detyruar të krijojnë dhe administrojnë dosjen personale të çdo të punësuarit në institucionin e tyre (dosja individuale). Dosja personale e zyrtarit publikë është individuale dhe krijohet që nga data e punësimit dhe përmban të dhëna: profesionale, personale, masat disiplinore, vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, si dhe të dhëna të tjera sipas shtojcës 1.1 të Rregullores (MPB) Nr.01/2020.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljes së lartcekur, në mënyrë që të gjitha dosjet e personelit të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

E GJETURA 2: Këshilli, gjatë shqyrtimit të dosjeve të nëpunësve civil dhe sipas deklarimeve të udhëheqësit të njesisë së burimeve njerëzore, ka gjetur se në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, gjatë vitit 2020 kanë qenë 25 pozita të lira të cilat janë ushtruar me ushtrues të detyrës, respektivisht zëvendësues, dhe kryesisht baza juridike e nxjerrjes së këtyre vendimeve ka qenë Ligji Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, dhe dispozitat e nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Këshilli vlerëson se dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht neni 18 paragrafi 5, neni 19 paragrafi 4 dhe neni 20 paragrafi 3 i referohen rasteve kur pozitat e punës janë të plotësuara me nëpunës civil mirëpo në raste të caktuara kur nëpunësi civil përkohësisht nuk mund të ushtroje detyrën për arsye të ndryshme si p.sh gjendet në pushim vjetor, mjekësor, vizitë jashtë vendi, etj, zëvendësohet nga nëpunësi civil sipas kriterëve të përcaktuara me dispozitat e lartcekura ligjore.

Ndërsa dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 32 paragrafi 4 i referohet rasteve të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të nëpunësit civil të përhershëm, dhe ky zëvendësim mund të behet për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj, p.sh zëvendësimi i nëpunësit civil që gjendet në pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, etj. Zëvendësimi në rastet e tilla

behet përmes procedurave të pranimit që zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.

Këshilli, duke marr parasysh se pozitat e punës kanë qenë të lira, konstaton se organi i punësimit gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e plotësimit të pozitave të lira me zëvendësues duke u thirrur në dispozitave të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, dhe dispozitat e nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Plotësimi i pozitave të lira është dashur të bëhet përmes zhvillimit të procedurave të lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Deri në plotësimin e vendit të lirë, organi i punësimit ka mundur te zbatoje procedurat e transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil në interes të institucionit, të përcaktuar në nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njësies së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljeve të konstatuara në mënyrë që plotësimi i pozitave të lira të behet sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

E GJETURA 3: Këshilli, gjatë mbikëqyrjes se zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka gjetur se Njësia për Burime Njerëzore ka përgatitur listën e nëpunësve civil dhe deklarimin e statusit të zyrtarëve publik dhe të njëjtën e ka përcjell për verifikim në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mirëpo ende nuk ka përfunduar procesi i deklarimit të statusit të zyrtarëve publikë.

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 83 paragrafi 16 përcaktohet se: 16. *Deklarimi apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njësies përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedura e deklarimit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative.* Procedura lidhur me deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë është përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Këshilli, konstaton se deklarimi i statusit të zyrtarëve publik ka qenë obligim ligjor që është dashur të përfundoj brenda afateve ligjore të përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Rekomandimi 3: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të zyrtarëve publikë, sipas dispozitave të nenit 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, dhe të sigurohet se deklarimi i statusit të bëhet përmes nxjerrjes së aktit administrativ sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka përgatitur Planin e Personelit për vitin 2020, mirëpo gjatë këtij viti nuk është zhvilluar asnjë procedurë e rekrutimit për faktin se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka qenë i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, deri më 09.07.2020.

Gjatë monitorimit Këshilli ka gjetur se në këtë institucion janë lidhur 46 kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta të cilat janë lidhur në fund të vitit 2019 dhe disa prej tyre kanë vazhduar deri në dhjetor 2020. Lidhur me angazhimin e tyre nuk ka pasur asnjë procedurë të rekrutimit, dhe po ashtu ka pasur tejkalim të afatit të kohëzgjatjes së këtyre kontratave.

Lidhur me këtë fushë Këshilli ka gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për shërbimeve të veçanta, ka gjetur se këto kontrata janë lidhur në kohën kur në zbatim ka qenë Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe i gjithë procesi është dashur të ndiqet sipas këtij ligji. Këshilli ka konstatuar se për lidhjen e këtyre marrëveshjeve nuk është zhvilluar asnjë procedurë nga Njësia për Burime Njerëzore. Për më tepër në trembëdhjetë (13) raste këto marrëveshje kanë qenë të lidhura për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj, në kundërshtim me nenin 12 paragrafin 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me nenin 84 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil Nr.03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publikë.

Andaj meqenëse marrëveshjet sipas të gjeturave nuk janë të vlefshme pas kalimit të afatit për të cilën janë lidhur, dhe duke marr parasysh rregullativen e re ligjore nuk është dhënë rekomandim në lidhje me këtë çështje.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Ministria e Industrisë Ndermarrësisë dhe Tregtisë, në bazë të Vendimit me numër Ref.02/Nr.373 të datës 22.12.2020 ka emëruar Komisionin Disiplinor, me mandat 3 vjeçar, mirëpo me Vendimin me numër Ref. 02/Nr.26 të datës 06.05.2021 i njëjti është shfuqizuar dhe nuk janë dhënë arsyet lidhur me shfuqizimin e tij.

Gjatë vitit 2020 në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë janë zhvilluar pesë (5) procedura disiplinore, prej tyre tri procedura kanë përfunduar me shqiptim të masave disiplinore, një kërkesë për inicim të procedurës disiplinore është refuzuar, ndërsa një rast është mbyllur pa nxjerrjen e një akti administrativ dhe rrjedhimisht pa masë disiplinore.

Në dy raste nëpunësve civil iu është shqiptuar masa disiplinore “largim nga shërbimi civil” të cilat masa janë konfirmuara si të ligjshme edhe nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Lidhur me këtë fushë kolegji ka gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli ka gjetur se organi i punësimit në bazë të Vendimit me numër Ref.02/Nr.373 të datës 22.12.2020 ka emëruar Komisionin Disiplinor, me mandat 3 vjeçar, mirëpo me Vendimin me numër Ref. 02/Nr.26 të datës 06.05.2021 i njëjti është shfuqizuar dhe nuk janë dhënë arsyet lidhur me shfuqizimin e tij. Këshilli konstaton se themelimi dhe përbërja e Komisionit Disiplinor janë të përcaktuara me dispozitat e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, dhe sipas dispozitave përkatëse ligjore mandati i anëtarëve të Komisionit Disiplinor është 3 vjet. Andaj, ndryshimi i përbërjes së Komisionit Disiplinor mund të bëhet vetëm në rastet e parapara me nenin 10 paragrafi 5 nën paragrafë 5.1, 5.2 dhe 5.3 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Ministria e Industrisë Ndermarrësisë dhe Tregtisë, përmes Vendimit me numër Ref. 02/Nr.26 të datës 06.05.2021, ka themeluar Komisionit e ri Disiplinor, me mandat 3 vjeçar. Në vendimin mbi themelimin e Komisionit Disiplinor, nuk janë përshkruar pozitat e kryesuesit dhe anëtarëve të këtij komisionit. Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në nenin 49 paragrafi 5 ka përcaktuar që Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, kështu që me Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë janë miratuar rregullat e hollësishme për këtë fushë, ku neni 10 ka përcaktuar mënyrën e themelimit të

Komisionit Disiplinor. Me nenin 10 paragrafi 2 përcaktohet se: “Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: *Nëpunës civil i nivelit drejtues - Kryesues i Komisionit; Nëpunës civil i nivelit profesional – anëtar dhe Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar*”. Andaj, meqenëse kjo dispozitë ka përcaktuar profesionin dhe nivelet e pozitave të anëtarëve të Komisionit Disiplinor, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në aktin e themelimit të Komisionit Disiplinor duhet të përshkruaj edhe pozitën dhe profesionin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale për plotësim/ndryshimin e vendimit mbi themelimin e Komisionit Disiplinor, dhe në vendim të shkruhet baza ligjore e emërimit të tij dhe të përshkruhen pozitat që mbajnë kryesuesi dhe anëtarët e komisionit, siç parashihet me nenin 10 të Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

E GJETURA 2: Këshilli gjatë shqyrtimit të rasteve të iniciuara të procedurës disiplinore, ka konstatuar se dy raste kanë qenë largim nga shërbimi civil të cilat janë vërtetuar me vendim nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Një masë është shqiptuar ndalim 20% e pagës për 2 muaj, në një rast është refuzuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore dhe në një rast tjetër nuk është nxjerr vendim nga Komisioni Disiplinor.

Gjatë shqyrtimit të rastit për të cilin nuk është nxjerr vendim, Këshilli ka gjetur se anëtarët e Komisionit Disiplinor përmes emalit kanë konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për të shqyrtuar rastin sepse njëherë duhet shteren mundësit e brendshme ligjore në kuadër të njësisë sipas nenit 47 dhe 48 të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor duhet t'i ushtroje përgjegjësit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Në çdo rast të iniciuar për shqyrtim, Komisioni Disiplinor duhet të nxjerr akt administrative sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Komisionin Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që me rastin e vendimmarrjes në një procedure disiplinore, për aq sa çështjet nuk rregullohen me dispozita të veçanta t'i aplikojë dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ka konstatuar se deri në hyrjen në fuqi të Ligjit Nnr.06/LP-114 për Zyrtarët Publikë (datë 09.07.2020) në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka qenë duke funksionuar

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave. Në vitin 2020 janë trajtuar 6 ankesa, ku 5 prej tyre janë refuzuar si te pa bazuara, ndërsa një ankesë është aprovuar nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji, ka konstatuar se në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nuk është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil. Rrjedhimisht bazuar në dosjet e shqyrtuara është konstatuar se për 11 nëpunës civil nuk është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2020.

Nga dosjet e shqyrtuara Këshilli ka gjetur se për nëpunësit civil të cilëve iu është bërë vlerësimi ato janë bërë brenda afateve ligjore. Po ashtu për 25 nëpunës civil gjatë vitit 2020 është bërë vlerësimi i periudhës provuese.

Lidhur me këtë fushë Këshilli ka gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli ka konstatuar se për 11 nëpunës civil nuk është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2020 edhe pse Njësia për Burime Njerëzore pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 04.12.2020 iu ka përcjell shkresën menaxhereve drejtues dhe i ka njoftuar se vlerësimi i rezultateve të punës duhet të bëhet deri më datë 31.01.2021.

Në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil është shkelje e dispozitave të 43 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullore Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që t'i ndërmarr te gjitha veprimet e nevojshme ligjore në mënyrë që të sigurohet se të gjithë nëpunësit civil janë vlerësuar nga menaxheret drejtues siç përcaktohet me dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

E GJETURA 2: Këshilli ka konstatuar se për 25 nëpunës civil është kryer vlerësimi i periudhës provuese, mirëpo nga vlerësimi i dosjeve të nëpunësve civil të punësuar në pozitën *Zyrtar për të Hyra Financiare*, dhe pozitën *Zyrtar për Marka Tregtare*, është vërejtur se vlerësimi i periudhës provuese nuk është bërë brenda afateve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr.02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civil, dhe rrjedhimisht as me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e cila e ka pasuar rregulloren paraprake Nr.02/2011.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore në mënyrë që të sigurohen se në të ardhmen vlerësimi i periudhës provuese për nëpunësit e rinj të bëhet në pajtim me procedurën dhe afatet e përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, evidenca e pushimeve të nëpunësve civil mbahet në kopje elektronike.

Lidhur me pushimet vjetore kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve ka vërejtur se nëpunësit civil kërkesën për shfrytëzimin e pushimit vjetor e realizojnë përmes sistemit SIMBNJ, mirëpo këto të dhëna nuk evidentohen edhe në dosje fizike të nëpunësve civil.

Me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, përkatësisht nenin 4 paragrafi 6 përcaktohet se Dosjet individuale ruhen ndaras, në formën fizike dhe elektronike (nëpërmjet SIMBNJ) dhe janë të njëjta si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike. Ato përditësohen nga secili institucion sa herë që ka ndryshime eventuale. Ndërsa në shtojcën 1.1 të kësaj rregulloreje parashihet se dosjet e personelit përmbajnë evidenca, vendimet, dëshmitë tjera të pushimeve të parapara me Ligj.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqshin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të ndërmerr veprime në mënyrë që edhe dosja personale në formë fizike e nëpunësve civil, të përmbaj të dhënat e pushimeve të njohura me ligj, siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Këshilli, gjatë monitorimit në këtë fushë, ka konstatuar se në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, gjatë vitit 2020 është bërë vetëm një transferim i përhershëm nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ku vendimi dhe marrëveshja janë lidhur mbi bazën e dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Lidhur me këtë fushë kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli ka gjetur se transferimi i nëpunësit civil është bere përmes Marrëveshjes së datës 15.07.2020 të lidhur mes Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i aplikueshëm nga data 09.07.2020 dhe me dispozitat e nenit 53 përcaktohet se: 1.Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil, në rastet: 1.1. të paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme; 1.2. e shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, të përcaktuar me ligj; 1.3. të përfundimit të pezullimit me kërkesë të nëpunësit civil kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës.

Rrjedhimisht, në rastin në fjalë nuk janë aplikuar dispozitat e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është nënshkruar marrëveshja për transferim të nëpunësit civil.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që me rastin e transferimit të nëpunësve civil t'i aplikojnë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Në vitin 2020, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kanë qenë të punësuar 253 nëpunës civil. Prej tyre 226 nëpunës civil janë të nacionalitetit shqiptar, 25 nëpunës serb, 1 nëpunës turk, dhe 1 nëpunës egjiptian. Nga 253 të punësuar me status të nëpunësit civil, 99 janë femra dhe 154 meshkuj. Në këtë institucion nuk ka të punësuar asnjë nëpunës civil me aftësi të kufizuara.

Në bazë të vlerësimit të të dhënave kemi gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli ka konstatuar se prej 253 nëpunësve civil të punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nuk ka të punësuar asnjë nëpunës civil me aftësi të kufizuara, dhe rrjedhimisht konstaton se ky institucion nuk ka respektuar nenin 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, ku parashihet se për çdo 50 të punësuar në shërbim civil një nëpunës duhet me qenë person me aftësi të kufizuara.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që t'i ndërmarr veprimet e duhura ligjore në mënyrë që t'ju jepet mundësia e punësimit personave me aftësi të kufizuara dhe të plotësohet kuota e përcaktuar me nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se ndaj katër nëpunësve civil është zhvilluar procedurë penale dhe kanë qenë në pezullim me 50% të pagës, ku dy prej tyre janë kthyer në vendin e punës për shkak se nuk është vërtetuar akuza. Gjatë vitit 2020, tre nëpunës civil kanë pezulluar marrëdhënien e punës, dhe dy prej tyre janë kthyer në punë pas përfundimit të periudhës së pezullimit.

Tre nëpunësve civil kanë ndërprerë në mënyrë të njëanshme marrëdhënien e punës si rezultat e dorëheqjes. Pesë nëpunësve civil i'u është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Një nëpunësi civil i është përfunduar marrëdhënia e punës pasi që është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për mbajtje të burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër.

Lidhur me këtë fushë nuk kemi konstatuar të gjetur dhe nuk kemi dhënë rekomandim.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve të marra si mostër dhe sipas deklaratimit të udhëheqësit të njësisë përgjegjëse ka konstatuar se në këtë institucion nuk ka raste ku nëpunësi civil në të njëjtën kohë mbanë dhe ndonjë post tjetër publikë.

Në këtë fushë të monitorimit nuk është gjetur shkelje dhe rrjedhimisht nuk janë dhënë rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Këshilli ka gjetur se ndaj dy nëpunësve civil të Ministrisë së Industrisë, Ndermarrësisë dhe Tregtisë është duke u zhvilluar procedurë penale.

Në këtë fushë të monitorimit nuk është gjetur shkelje dhe rrjedhimisht nuk janë dhënë rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Këshilli ka konstatuar se Njësia për Burime Njerëzore ka përgatitur Planin e Trajnimeve dhe i njëjti ka filluar të zbatohet përmes pjesëmarrjes së nëpunësve civil në trajnimet e organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike.

Në këtë fushë të monitorimit nuk është gjetur shkelje dhe rrjedhimisht nuk janë dhënë rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Këshilli, gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Industrisë, Ndermarrësisë dhe Tregtisë, prezenca në punë e nëpunësve

civil evidentohet përmes sistemit elektronik. Sipas informacioneve të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore, në sistemin elektronik të prezencës në punë nuk regjistrohen të gjithë nëpunësit civil.

Për këtë fushë Këshilli ka konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli duke ju referuar deklaratës së Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore, dhe dëshmive tjera të ofruara nga organi i punësimit ka konstatuar se njëzetepesë (25) nëpunës civil të nacionalitetit serb nuk posedojnë vlerësimin e rezultateve të punës dhe për të njëjtit nuk ka dëshmi të vijueshmërisë në punë.

Këshilli konstaton se mos paraqitja në punë pa arsye dhe largimi nga puna pa paralajmërim të menaxherit drejtues është vepër e sanksionuar me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Menaxherin e Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura në drejtim të plotësimit të kushteve të përshtatshme të punës për të gjithë zyrtarët publikë të punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, siç përcaktohet me nenin 18 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe rrjedhimisht në kuptim të mbikëqyrjes së vijueshmërisë në punë të veprohet në pajtim me nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Gjatë vitit 2020 ky institucion ka pranuar shtatëmbëdhjetë (17) vendime të Këshillit, dhe rrjedhimisht është konstatuar se të njëjtat janë zbatuar.

15. NGACMIMET SEKSUALE

Në pajtim me Politikën Kundër Ngacimit Seksual në Institucionet e Administratës Publike, të miratuara me datë 25.11.2020 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Këshilli në planin e monitorimit ka përfshirë si indikator edhe çështjen e ngacimit seksual. Gjatë vizitës së monitorimit nuk është raportuar për asnjë rast të kësaj natyre dhe rrjedhimisht nuk është evidentuar ndonjë e gjetura në këtë fushë.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

16. KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM

Këshilli gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar dymbëdhjetë (12) të gjetura dhe ka dhënë njëmbëdhjetë (11) rekomandime. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për



shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim
Profesional

Jeton KOÇA

Jeton Koça
Kryetar i Kolegjit



Raporti i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së